



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE *MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të pikës 1.1 të Rregullores së UNMIK-ut 199/1, nenit 3 të Ligjit për eksproprijim (Gaz. Zyrtare e Kosovës nr. 21/78), neni 3 a të Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për eksproprijim (Gaz. Zyrtare e Kosovës nr. 46/86), Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 13.06.2003 merr,

V E N D I M
PËR PËRCAKTIMIN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM PËR
NDËRTIMIN E LARGËPËRÇUESIT 35 KV DREJTIMI PRISHTINA I -
MAZGIT- KOLIQ

Neni 1

Përcaktohet se është në interes të përgjithshëm ndërtimi i largëpërquesit 35 KV, drejtimi Prishtina I – Mazgit – Koliq dhe lejohet hapja e procedurës për eksproprijim-konstituim të së drejtës të servitutit dhe bartje administrative në palujtshmëri që gjenden në teritorin e Komunës së Prishtinës, përkatësisht në zonën kadastrale Shkabaj dhe Prishtinë, që përfshihen ngastrat kadastrale me sipërfaqe adekuate të pronarëve fizik dhe juridikë, afërsisht e precizuar dhe e përshkruar në Elaboratin ekspropriues që është pjesë përbërse e këtij Vendimi.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtorati për Financa dhe Pronë, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtimtari si dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr 312-1183 Dt.01.06.2003

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri